



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.20

12 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 229 datë 11.2.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të qendrave rajonale të emergjencës në Republikën e Shqipërisë”	613
Ligj nr. 10 230 datë 11.2.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë dhe të financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt Am Main dhe fondacionit “FEFAD” për projektin “Promovimi i SME-ve”	614
Ligj nr.10 231 datë 11.2.2010	Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA)	621
Ligj nr. 10 232 datë 11.2.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit”	630
Ligj nr.10 233 datë 11.2.2010	Për Autoritetin e Aviacionit Civil	637
Ligj nr.10 254 datë 11.3.2010	Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore	644

LIGJ
Nr.10 229, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË JAPONISË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN E PAJISJEVE MJEKËSORE TË QENDRAVE RAJONALE TË EMERGJENCËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të qendrave rajonale të emergjencës në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6437, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Draft
(Notave japoneze)

Shkëlqesi,

Kam nderin t’u referohem diskutimeve të fundit mbajtur midis përfaqësuesve të Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përsa i përket bashkëpunimit ekonomik japonez për t’u ofruar me synimin e forcimit miqësor dhe marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet dy vendeve dhe të propozojë në emër të Qeverisë së Japonisë mirëkuptimin e mëposhtëm:

1.1) Për qëllim ndihme në zbatimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të qendrave të emergjencës në nivel rajonal (këtej e tutje referuar si “Projekti” nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Qeveria e Japonisë ka vendosur që një grant prej 718 000 000 jen japonez (këtej e tutje, referuar si “grant”) t’i ofrohet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet përkatëse dhe rregullat japoneze.

2) Granti do të bëhet i vlefshëm me konkludimin e një marrëveshjeje granti ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose autoritetit të tij të përcaktuar dhe Agjencisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar Japonez (JICA) (këtej e tutje e referuar si “G/A”).

3) Termat dhe kushtet e grantit, si dhe procedurat për përdorimin e tij do të rregullohen nga G/A brenda objektit të marrëveshjes së mirëkuptimit aktual.

2. Granti do të jetë i vlefshëm gjatë një periudhe të tillë, siç mund të specifikohet në G/A, me kusht që periudha do të jetë ndërmjet datës së hyrjes në fuqi të G/A dhe XXX.

3. Granti do të përdoret nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë siç duhet dhe vetëm për blerjen e këtyre produkteve dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e projektit siç mund të specifikohet në G/A (këtej e tutje respektivisht referuar si “produktet” dhe “shërbimet”).

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose autoriteti i përcaktuar prej saj do të lidhë kontrata në jen japonez me shtetas japonezë për blerjen e produkteve dhe shërbimeve. Kontrata të tilla do të verifikohen nga JICA, që të jenë të pranueshme për grantin. (Termi “shtetas japonezë”, kurdo që përdoret në marrëveshjen e mirëkuptimit aktual, nënkupton persona fizikë japonezë ose persona juridikë japonezë të kontrolluar nga persona fizikë japonezë.)

5. Granti do të zbatohet nga JICA, në përputhje me dispozitat e G/A, duke bërë pagesat në jen japonez në një llogari që do të hapet në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në një bankë në Japoni të caktuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose autoriteti i tij i përcaktuar.

6.1) Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të marrë masat e nevojshme:

a) Të sigurojë shkarkim të menjëhershëm dhe zhdoganim në portin e shkarkimit në Republikën e Shqipërisë dhe ta asistojë atje transportin e brendshëm të produkteve;

b) Të sigurojë përjashtimin nga detyrimet doganore, taksat e brendshme dhe detyrime të tjera fiskale, të cilat mund të vihen në Republikën e Shqipërisë, përsa i përket blerjes së produkteve dhe shërbimeve;

c) T’u akordojë shtetasve japonezë, shërbimet e të cilëve mund të kërkohen në lidhje me furnizimin e produkteve dhe shërbimeve, lehtësira të tilla siç mund të jenë të nevojshme për hyrjen e tyre në Republikën e Shqipërisë dhe qëndrimin për përmbushjen e punës së tyre;

d) Të sigurojë që produktet të mirëmbahen dhe të përdoren siç duhen dhe efektivisht për zbatimin e projektit;

e) Të mbulojë të gjitha shpenzimet, përveç atyre të mbuluara nga granti, të nevojshme për zbatimin e projektit; dhe

f) Të japë vlerësimin mjedisor dhe social përkatës në zbatimin e projektit.

2) Mbi bazën e kërkesës, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t’i sigurojë Qeverisë së Japonisë informacione të nevojshme për projektin.

3) Përsa i përket transportit dhe siguracionit detar të produkteve, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të shmangë vendosjen e ndonjë kufizimi që mund të pengojë konkurrencën e lirë dhe të ndershme ndërmjet kompanive transportuese dhe atyre të siguracioneve detare.

4) Produktet nuk eksportohen ose riekportohen nga Republika e Shqipërisë.

7. Të dy qeveritë do të konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me ndonjë çështje që mund të ngrihet ose në lidhje me mirëkuptimin aktual.

Kam nderin të propozoj që kjo Notë dhe Nota e Shkëlqesisë Suaj si përgjigje konfirmimi të mirëkuptimit paraparak në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë përbën një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e Notës së Shkëlqesisë Suaj si përgjigje.

Përfitoj nga kjo mundësi për t’i shprehur Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratave të mia më të larta.

LIGJ

Nr. 10 230, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË DHE TË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU (KfW), FRANKFURT AM MAIN DHE FONDACIONIT “FEFAD” PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I SME-VE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë dhe e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe fondacionit “FEFAD” për projektin “Promovimi i SME-ve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6438, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROJEKT-MARRËVESHJE E HUASË DHE FINANCIMIT

MIDIS KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE (HUAMARRËSIT), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE FONDACIONIT PËR FINANCIM NDËRMARRJESH DHE ZHVILLIM (FEFAD) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 2 600 000 EURO (HUA), 210 000 EURO (KONTRIBUT FINANCIAR)
PROMOVIMI I SME

Në bazën e një marrëveshjeje në proces midis Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (Marrëveshje qeveritare), Huamarrësi, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW, me anë të kësaj, hyjnë në Marrëveshjen e mëposhtme të huasë dhe financimit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë

1.1 KfW do t'i ofrojë Huamarrësit një hua, që arrin në 2 600 000 euro dhe një kontribut financiar prej 210 000 eurosh.

Kontributi financiar nuk është i pagueshëm, vetëm nëse përcaktohet ndryshe në nenin 5.3.

1.2 Huamarrësi do t'ia kanalizojë plotësisht huanë agjencisë së zbatimit të projektit në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2, si dhe kontributin financiar si një grant jo i kthyeshëm.

1.3 Agjencia e zbatimit të projektit do ta përdorë huanë dhe kontributin financiar (shuma përkatëse e këtyre të dyjave do të referohet këtej e tutje si "shuma") tërësisht për promovimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në rajonet urbane dhe rurale (projekt).

1.4 Huaja do të përdoret vetëm për rifinancimin e huave të dhëna nga agjencia e ekzekutimit të projektit ndaj institucioneve financiare shqiptare (nënhua) të cilat u japin hua ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (nënprojekte). Fondet që rikthehen në agjencinë e zbatimit të projektit si pagesë e nënhuave, do të përdoren në mënyrë qarkulluese, vetëm nëse nuk kërkohet që të rimburojnë huanë. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë kushtet për nënkontratën me marrëveshje të veçantë.

1.5 Kontributi financiar do të përdoret, sapo të arrihen të gjitha parakushtet e nevojshme për disbursim, për shërbime konsulente për institucionet financiare që do të përcaktohen me detaje në kohën e duhur përpara fillimit të shërbimeve.

1.6 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit dhe mallrat e shërbimet për t'u financuar nga kontributi financiar me marrëveshje të veçantë.

1.7 Taksat dhe tarifat e tjera publike për t'u përballuar nga Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit dhe taksat e tjera të importit nuk do të financohen nga fondet e huasë apo të kontributit financiar.

Neni 2

Kanalizimi i huasë tek agjencia e zbatimit të projektit

2.1 Huamarrësi do të kanalizojë huanë menjëherë tek agjencia e zbatimit të projektit sipas një marrëveshjeje të veçantë kanalizimi me një përqindje interesi prej 0.75% për një periudhë kohe prej 12 vjetësh, përfshirë periudhën e shlyerjes prej 10 vjetësh. Interesi do të llogaritet nga data që disbursimet do të debitoohen deri në datën që pagesat do të kreditohen në llogarinë e Huamarrësit.

2.2 Përpara disbursimit të huasë, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një kopje të marrëveshjes së ekzekutuar të kanalizimit të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë dhe kontributit financiar nuk do të përbëjë asnjë detyrim për agjencinë e zbatimit të projektit ndaj KfW-së për pagesat e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW do të disbursojë huanë, në përputhje me progresin e projektit dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Me një marrëveshje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, veçanërisht evidencën që vërteton se shumtat e kërkuara të huasë janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW mund të refuzojë të bëjë disbursime pas 31 dhjetorit 2008.

Neni 4

Përqindja e angazhimit, interesi dhe ripagesa

4.1 Huamarrësi do të paguajë një përqindje angazhimi prej ¼ % p.a. mbi shumën e padisbursuar të huasë. Përqindja e angazhimit do të llogaritet për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe përfundon në datën në të cilën disbursimet debitohen.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interes mbi huanë prej 0.75 % p.a. Interesi do të llogaritet nga dita në të cilat disbursimet janë debituar deri në ditën në të cilën ripagesat janë kredituar në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë përqindjen e angazhimit, interesin dhe çdo lloj interesi të prapambetur në vijim të nenit 4.5 dy herë në vit në 30 qershor dhe 30 dhjetor. Përqindja e angazhimit e ka afatin deri në pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do ta paguajë huanë si vijon:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 dhjetor	2015	43.000,00	Euro
2	30 qershor	2016	43.000,00	Euro
3	30 dhjetor	2016	43.000,00	Euro
4	30 qershor	2017	43.000,00	Euro
5	30 dhjetor	2017	43.000,00	Euro
6	30 qershor	2018	43.000,00	Euro
7	30 dhjetor	2018	43.000,00	Euro
8	30 qershor	2019	43.000,00	Euro
9	30 dhjetor	2019	43.000,00	Euro
10	30 qershor	2020	43.000,00	Euro
11	30 dhjetor	2020	43.000,00	Euro
12	30 qershor	2021	43.000,00	Euro
13	30 dhjetor	2021	43.000,00	Euro
14	30 qershor	2022	43.000,00	Euro
15	30 dhjetor	2022	43.000,00	Euro
16	30 qershor	2023	43.000,00	Euro
17	30 dhjetor	2023	43.000,00	Euro
18	30 qershor	2024	43.000,00	Euro
19	30 dhjetor	2024	43.000,00	Euro
20	30 qershor	2025	43.000,00	Euro
21	30 dhjetor	2025	43.000,00	Euro

22	30 qershor	2026	43.000,00	Euro
23	30 dhjetor	2026	43.000,00	Euro
24	30 qershor	2027	43.000,00	Euro
25	30 dhjetor	2027	43.000,00	Euro
26	30 qershor	2028	43.000,00	Euro
27	30 dhjetor	2028	43.000,00	Euro
28	30 qershor	2029	43.000,00	Euro
29	30 dhjetor	2029	43.000,00	Euro
30	30 qershor	2030	43.000,00	Euro
31	30 dhjetor	2030	43.000,00	Euro
32	30 qershor	2031	43.000,00	Euro
33	30 dhjetor	2031	43.000,00	Euro
34	30 qershor	2032	43.000,00	Euro
35	30 dhjetor	2032	43.000,00	Euro
36	30 qershor	2033	43.000,00	Euro
37	30 dhjetor	2033	43.000,00	Euro
38	30 qershor	2034	43.000,00	Euro
39	30 dhjetor	2034	43.000,00	Euro
40	30 qershor	2035	43.000,00	Euro
41	30 dhjetor	2035	44.000,00	Euro
42	30 qershor	2036	44.000,00	Euro
43	30 dhjetor	2036	44.000,00	Euro
44	30 qershor	2037	44.000,00	Euro
45	30 dhjetor	2037	44.000,00	Euro
46	30 qershor	2038	44.000,00	Euro
47	30 dhjetor	2038	44.000,00	Euro
48	30 qershor	2039	44.000,00	Euro
49	30 dhjetor	2039	44.000,00	Euro
50	30 qershor	2040	44.000,00	Euro
51	30 dhjetor	2040	44.000,00	Euro
52	30 qershor	2041	44.000,00	Euro
53	30 dhjetor	2041	44.000,00	Euro
54	30 qershor	2042	44.000,00	Euro
55	30 dhjetor	2042	44.000,00	Euro
56	30 qershor	2043	44.000,00	Euro
57	30 dhjetor	2043	44.000,00	Euro
58	30 qershor	2044	44.000,00	Euro
59	30 dhjetor	2044	44.000,00	Euro
60	30 qershor	2045	44.000,00	Euro

4.5 Nëse ndonjë këst i ripagesës nuk shlyhet kur duhet për KfW-në, KfW mund ta rrisë përqindjen e interesit të prapambetur mbi përqindjen bazë plus 3% p.a. për periudhën që fillon në datën e skadimit dhe përfundon në ditën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogari të KfW-së të specifikuar në nenin 4.9. “Përqindja bazë” është përqindja e interesit e deklaruar nga Deutsche Bundesbank si përqindje bazë mbi përqindjen e aplikueshme në datën përkatëse të skadimit. Në rast të interesave të prapambetur, KfW mund të paraqesë ankesë për dëmtim. Këto lloj dëmtimesh nuk duhet të kalojnë shumën që do të arrihej nëse interesi do të llogaritej mbi interesat e prapambetur në përqindjen bazë të datës së skadimit plus 3%.

4.6 Përqindja e angazhimit, interesi dhe ndonjë tarifë e prapambetur në vijim të nenit 4.5 duhet të llogariten në bazën e vitit prej 360 ditësh dhe muajit prej 30 ditësh.

4.7 Shumat e huasë të padisbursuara apo të paguara para datës së skadimit do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha kësteve të mbetura për t’u paguar, përveç rasteve kur KfW përcakton një mënyrë tjetër kompensimi, veçanërisht për rastet kur shumat janë në një volum më të vogël.

4.8 KfW mund të kreditojë pagesat e marra kundrejt pagesave në kohë sipas kësaj marrëveshjeje apo sipas marrëveshjeve të tjera të huasë të lidhura midis KfW dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi duhet të bëjë pagesat në euro në llogarinë e KfW me numër 31 39547450 në KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, SWIFT: KFWIDEFF).

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat para afatit

5.1 Huamarrësi mundet që në çdo kohë:

- a) atë anulojë çdo shumë huaje ende të padisbursuar, dhe
- b) të ripaguajë huanë të tërë apo pjesërisht përpara maturitetit.

5.2 KfW nuk mund t’i pezullojë disbursimet, përveç rasteve kur:

- a) Huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimet e tij ndaj KfW për të bërë pagesat në datën e duhur;
- b) detyrimet, sipas kësaj marrëveshjeje apo marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje, nuk janë respektuar;
- c) agjencia e zbatimit të projektit nuk ka mundësi të provojë se shumat janë përdorur për qëllimin e përcaktuar; ose

d) rrethana të jashtëzakonshme pengojnë seriozisht zbatimin, operimin, qëllimin e këtij projekti apo realizimin e pagesave të detyrimeve nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e specifikuara në nenin 5.2 “a”, “b” apo “c” dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW, e cila megjithatë do të jetë jo më pak se 30 ditë, KfW mundet:

- a) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 “a”, të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë shumës së mbetur të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit të llogaritur, si dhe të gjitha tarifat e tjera që mund të kenë ndalë;
- b) në rastet e specifikuara në nenin 5.2 “b”, të kërkojë pagesën e menjëhershme të të gjithë shumës së mbetur, si dhe pagesën e të gjithë interesit të llogaritur dhe të gjitha tarifat e tjera të papritura, si dhe pagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara të kontributit financiar;
- c) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 “c”, të kërkojë pagesën e menjëhershme të shumave të tilla që agjencia e zbatimit të projektit nuk arrin të provojë – në mënyrë të kënaqshme për KfW-në që janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 6

Kostot dhe tarifat publike

6.1 Huamarrësi duhet të bëjë pagesat që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje, pa bërë asnjë zbritje për taksat, tarifa të tjera publike apo kosto të tjera, dhe do të paguajë koston e transferimit dhe konvertimit në lidhje me disbursimin e huasë. Në rastin e kontributit financiar, kosto të tilla do të përballohen nga Huamarrësi.

6.2 Huamarrësi do të përballojë të gjitha taksat dhe tarifat e tjera publike që dalin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e Marrëveshjes së huasë dhe financimit dhe përfaqësimi

7.1 Në kohën para disbursimit të parë, Huamarrësi do të pajisë KfW-në me evidenca të kënaqshme që provojnë se Huamarrësi ka përmbytur të gjitha kërkesat sipas ligjeve kushtetuese dhe të tjera për vlefshmërinë e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Ministri i Financave dhe personat e autorizuar nga ai/ajo për KfW dhe me firmë të autorizuar nga ai apo ajo do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e autorizuar nga ai/ajo për KfW dhe të autorizuar nga ai apo ajo do të përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të përfundojnë deri në marrjen nga KfW të shprehjes së revokimit nga përfaqësuesit e autorizuar në atë kohë.

7.3 Ndryshimet apo shtesat në këtë Marrëveshje dhe çdo njoftim i lëshuar nga palët e kontraktuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo deklaratë apo njoftim do të quhen të marra sapo të kenë mbërritur në adresat e mëposhtme të palëve korresponduese të kontraktuara apo në ndonjë adresë tjetër të palës korresponduese të kontraktuar, ashtu siç është lajmëruar për palën tjetër kontraktuese.

7.4 Ndryshimet në këtë marrëveshje që i përkasin marrëdhënies ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit, nuk kërkojnë miratimin nga agjencia e zbatimit të projektit.

Për KfW: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Ministria e
Financave
Bulevardi "Dëshmorët e
Kombit"
Tiranë, Albania
Telefax: 00355-4-228494

Për agjencinë e zbatimit FEFAD
të projektit:
Rruga: "Themistokli Germeji"
P. 7, Ap.11
Tirana, Albania
Telefax: 00355- 4- 234177.

Neni 8

Ekzekutimi i Marrëveshjes së huasë dhe financimit

8.1 Nënprojektet duhet të jenë të sigurta nga ana ekonomike, financiare dhe teknike dhe të konsiderohen të përshtatshme për promovimin e synimeve ekonomike dhe të zhvillimit të politikave.

8.2 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe/ose mirëmbajë projektin, në përputhje me praktikën e shëndetshme financiare dhe inxhinierike dhe konceptimin e projektit të rënë dakord midis saj dhe KfW-së;

b) do të menaxhojë projektin dhe sigurojë që çdo shumë e huasë dhe kontributit financiar të menaxhohet në përputhje me praktika të shëndosha bankare dhe rregullat e saj, me këtë Marrëveshje dhe me marrëveshjet përkatëse të veçanta;

c) do të përzgjedhë institucionet financiare shqiptare që marrin pjesë në nënprojekte me verifikimin e disponibilitetit të tyre dhe kompetencave teknike dhe përpara se t'u japë ndonjë nënhua, duhet t'ia dërgojë këto dokumente KfW-së që të mund t'i vlerësojë këto banka. Kushtet e nënhuave për institucionet financiare duhet të përcaktohen midis agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së me marrëveshje të veçanta;

d) do të vlerësojë kontratën për shërbimet dhe mallrat për t'u financuar nga kontributi financiar për firmat konsulente të pavarura dhe të kualifikuara. Detajet do të përcaktohen midis KfW dhe agjencisë së zbatimit të projektit me marrëveshje të veçantë;

e) do të disbursojë shumën nga huaja dhe kontributi financiar vetëm në përputhje me progresin e nënhuave dhe shërbimeve konsulente, respektivisht;

f) do ta pajisë KfW me të gjitha këto informacione dhe raporte mbi përdorimin e duhur të Huasë dhe kontributit financiar, siç mund ta kërkojë KfW dhe mbajë, apo të kërkojë të mbahen dosje dhe

regjistrime me të dhëna mbi nënhuatë e projektit dhe identifikojë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

g) do t'i mundësojë KfW –së apo përfaqësuesit e saj që në çdo kohë të inspektojnë çdo dosje apo regjistrim që i përkasin huasë dhe kontributit financiar dhe përdorimin e tyre, si dhe raportet e financiarëve dhe audituesve në departamentet e tyre dhe auditorëve të jashtëm, gjithashtu do ta pajisë KfW-në me çdo informacion siç mund të kërkojë kjo e fundit në mënyrë të arsyeshme;

h) do të sigurojë që, për sa kohë që detyrimet e pagesave ekzistojnë sipas nënhuasë së dhënë institucioneve financiare, përfaqësuesit e KfW-së – me kërkesë të KfW-së së bashku me përfaqësuesit e Huamarrësit – mundën në çdo kohë të verifikojnë përdorimin e duhur të huasë gjithashtu dhe duke vizituar institucionet financiare dhe klientët e tyre të rifinancuar nga projekti, dhe mund të shohin dokumentet për situatën financiare të institucioneve financiare dhe deklarimin e fitimit;

i) me aprovimin e saj, do të informojë menjëherë KfW-në për çdo ndryshim në statusin e korporatës, nënligjet e saj dhe ndonjë rregull tjetër ose ndonjë ndryshim në menaxhimin e saj, si dhe të çdo lloj situatë që pengon seriozisht arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje dhe

j) do t'i dërgojë KfW-së menjëherë me përfundimin e tyre, raportet vjetore dhe bilancet përkatëse dhe fitimin, së bashku me të dhënat shpjeguese.

8.3 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-në do të përcaktojnë detajet përkatëse të nenit 8.2 “a” – “f” në një marrëveshje të veçantë.

8.4 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, sipas kërkesës, të pajisin KfW-në me evidenca që provojnë se kostot jo të paguara nga kontributi financiar janë mbuluar; dhe

b) me miratimin e tyre, të informojnë KfW për çdo lloj rrethane që mund të pengojë seriozisht ekzekutimin apo qëllimin e Marrëveshjes së financimit dhe huasë.

8.5 Huamarrësi duhet të ndihmojë agjencinë e zbatimit të projektit për ekzekutimin e Marrëveshjes së financimit dhe huasë dhe në zbatimin e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht, do t'i japë lejet e nevojshme për ekzekutimin e Marrëveshjes së financimit dhe huasë.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit do të sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e kësaj huaje dhe procedimin me nënhanë dhe me kërkesën për disbursimin e shumave të huave të mos kërkojnë, supozojnë, japin, premtojnë apo marrin ndonjë premtim për pagesa të jashtëligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Nëse ndonjë nga këto kushte të kësaj Marrëveshjeje nuk është i vlefshëm, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të paprekura. Çdo mospërputhje nga kjo do të mbulohet me një dispozitë të qëndrueshme, për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të japin, transferojnë apo depozitojnë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshjeje do të udhëhiqet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i ekzekutimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Kjo Marrëveshjeje e financimit dhe huasë do të hyjë në fuqi kur marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo bazohet ka hyrë në fuqi.

E përgatitur në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,

Tiranë,

KfW

REPUBLIKA E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Ministria e Financave

FONDACIONI PËR FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE
DHE ZHVILLIM

Neni i arbitrazhit

Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha mosmarrëveshjet mbi ligjshmërinë e kësaj marrëveshjeje dhe të këtij neni të arbitrazhit që nuk mund të zgjidhen midis palëve kontraktuese do të dërgohen për arbitrazh, siç është rënë dakord në marrëveshjen e arbitrazhit që i përket Marrëveshjes së huasë dhe projektit të datës 24 tetor, 1995 (Fondacioni bankë I) midis KfW, Bankës së Shqipërisë dhe FEFAD dhe të marrëveshjes respektive të ndryshimeve të datës 17 prill, 1998 midis KfW-së, Republikës së Shqipërisë dhe FEFAD për Fondacionin Bank I+II. Ligjshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit do të shtyhet deri sa të realizohen të gjitha detyrimet për pagesa sipas Marrëveshjes së mësipërme.

Frankfurt am Main

Tiranë

KfW

REPUBLIKA E SHQIPËRISË,
përfaqësuar nga Ministria e Financave

LIGJ

Nr.10 231, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (IRENA)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet statuti i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA), sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6439, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONFERENCË MBI NGRITJEN

E AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME Statuti i IRENA-s, i nënshkruar në Bon

E hënë, 26 janar 2009
Bon, Qendra e Konferencës Botërore

IRENA/CF/Statuti

STATUT

I AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (IRENA)

Palët në këtë statut,

me dëshirën për të nxitur zbatimin dhe përdorimin e gjerë dhe intensiv të energjisë së rinovueshme me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm;

të frymëzuar nga besimi i tyre i thellë në mundësinë e gjerë të ofruar nga energjia e rinovueshme për të trajtuar dhe gradualisht zgjidhur problemet e sigurisë së energjisë dhe çmimet e paqëndrueshme të energjisë;

të bindur për rolin e madh që energjia e rinovueshme mund të luajë në uljen e përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë, duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilizimin e sistemit klimaterik dhe duke mundësuar një kalim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të lehtë në një ekonomi me karbon të ulët;

me dëshirën për të forcuar ndikimin pozitiv që teknologjitë e energjisë së rinovueshme kanë për stimulimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe krijimin e vendeve të punës;

të motivuar nga potenciali i madh i energjisë së rinovueshme në mundësimin e pa-centralizuar të energjisë, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe mundësimin e energjisë për rajonet dhe ishujt e largët;

të shqetësuar për ndikimet serioze negative që përdorimi i karburanteve fosile dhe përdorimi jo i efektshëm i biomasës tradicionale mund të kenë mbi shëndetin;

të bindur që energjia e rinovueshme, e kombinuar me efikasitetin e shtuar të energjisë, mund të mbulojë gjithnjë e më shumë rritjen e menjëhershme të parashikuar në nevojat për energji në dekadat në vazhdim;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Themelimi i agjencisë

A. Palët në këtë statut themelojnë Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë e Rinovueshme (këtu quhet "Agjencia") në pajtim me termat dhe kushtet e mëposhtme.

B. Agjencia bazohet në parimin e barazisë së të gjithë anëtarëve të saj dhe u kushton respektin e duhur të drejtave dhe kompetencave sovrane të anëtarëve në ushtrimin e aktiviteteve të saj.

Neni 2

Objektivat

Agjencia nxit zbatimin e gjerë dhe intensiv, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të të gjitha formave të energjisë së rinovueshme, duke marrë parasysh:

a) prioritetet dhe përfitimet kombëtare dhe të brendshme që rrjedhin nga një trajtim i kombinuar i masave për energjinë e rinovueshme dhe efektshmërinë e energjisë, dhe

b) kontributin e energjisë së rinovueshme në ruajtjen e ambientit, nëpërmjet kufizimit të presionit mbi burimet natyrore dhe uljes së shpyllëzimit, veçanërisht shpyllëzimit tropikal, humbjes së biodiversitetit dhe dezertifikimit; për mbrojtjen e klimës; për rritjen ekonomike dhe kohezionin social duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm; mundësimin dhe garantimin e furnizimit me energji elektrike; zhvillimin rajonal dhe përgjegjësinë ndërmjet brezave.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë statut termi “energji e rinovueshme” do të thotë të gjitha format e energjisë që prodhohen nga burimet e energjisë së rinovueshme në një mënyrë të qëndrueshme, që përfshin, ndër të tjera:

1. bioenergjinë;
2. energjinë gjeotermike;
3. energjinë ujore;
4. energjinë oqeanike, duke përfshirë ndër të tjera, energjinë e baticës, valës dhe termale oqeanike;
5. energjinë solare; dhe
6. energjinë e erës.

Neni 4
Aktivitetet

A. Si qendër ekselence për teknologjinë e energjisë së rinovueshme dhe duke vepruar si ndihmuese dhe katalizatore, duke dhënë eksperiencë për aplikime dhe politika praktike, duke ofruar mbështetje për të gjitha çështjet në lidhje me energjinë e rinovueshme dhe duke ndihmuar vendet të përfitojnë nga zhvillimi efikas dhe transferimi i njohurive dhe teknologjisë, Agjencia kryen aktivitetet e mëposhtme:

1. Veçanërisht në përfitim të anëtarëve të saj, Agjencia:
 - a) Analizon, monitoron dhe, pa detyruar politikat e anëtarëve të saj, sistemon praktikat e tashme të energjisë së rinovueshme, duke përfshirë instrumentet e politikave, shtysat, mekanizmat e investimit, praktikat më të mira, teknologjitë e disponueshme, sistemet dhe pajisjet e integruara dhe faktorët e suksesit dhe dështimit;
 - b) Fillon diskutime dhe siguron ndërveprimin me organizata dhe rrjete të tjera qeveritare dhe joqeveritare në këtë fushë dhe fusha të tjera përkatëse;
 - c) U jep anëtarëve këshilla përkatëse mbi politikat dhe asistencë me kërkesë të tyre, duke marrë parasysh nevojat e tyre përkatëse dhe stimulon diskutimet ndërkombëtare për politikën e energjisë së rinovueshme dhe kushtet e saj kuadër;
 - d) Përmirëson njohuritë përkatëse dhe transferimin e teknologjisë dhe nxit zhvillimin e kapaciteteve dhe kompetencave lokale të shtetave anëtare duke përfshirë ndërlidhjet e nevojshme;
 - e) Ofron ndërtim kapacitetesh, duke përfshirë trajnimin dhe edukimin e anëtarëve të saj;
 - f) U jep anëtarëve të saj, me kërkesë të tyre, këshilla mbi financimin për energjinë e rinovueshme dhe mbështet zbatimin e mekanizmave përkatës;
 - g) Stimulon dhe inkurajon kërkimin, duke përfshirë çështjet social-ekonomike dhe nxit rrjetet e kërkimit, kërkimin e përbashkët, zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive; dhe
 - h) Jep informacion në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e standardeve teknike kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me energjinë e rinovueshme, bazuar në një mirëkuptim të shëndoshë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në forumet përkatëse.

2. Për më tepër, Agjencia shpërndan informacion dhe rrit ndërgjegjësimin publik mbi përfitimet dhe potencialin e ofruar nga energjia e rinovueshme.

B. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj, Agjencia:

1. Vepron në pajtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara për nxitjen e paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe në pajtim me politikat e Kombeve të Bashkuara që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm;

2. I ofron burimet e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë përdorimin efikas me qëllim trajtimin e përshtatshëm të të gjithë objektivave të saj dhe i kryen aktivitetet e saj për të arritur përfitimin më të madh të mundshëm për anëtarët e saj dhe në të gjitha zonat në botë, duke pasur parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim dhe rajoneve dhe ishujve të largët;

3. Bashkëpunon ngushtë dhe përpjet për vendosjen e raporteve me përfitim të dyanshëm me institucionet dhe organizatat ekzistuese, me qëllim mënjanimin e dublikimit të panevojshëm të punës dhe për t'u mbështetur dhe përdorur me efikasitet dhe efikasitet burimet dhe aktivitetet në vazhdim të qeverive, organizatave të tjera dhe agjencive, që synojnë nxitjen e energjisë së rinovueshme.

- C. Agjencia:
1. u paraqit anëtarëve të saj raport vjetor mbi aktivitetin e saj;
 2. informon anëtarët në lidhje me këshillat e saj mbi politikën, pasi të jenë dhënë; dhe
 3. informon anëtarët në lidhje me konsultimin dhe bashkëpunimin dhe punën e organizatave ekzistuese që punojnë në këtë fushë.

Neni 5

Programet e punës dhe projektet

A. Agjencia i zbaton aktivitetet e saj mbi bazën e programeve vjetore të punës, të përgatitura nga sekretariati, të shqyrtuara nga këshilli dhe miratuar nga asambleja.

B. Agjencia, përveç programit të saj të punës, pas konsultimeve me anëtarët dhe, në rastin e mosmarrëveshjes, pas aprovimit nga asambleja, mund të zbatojë projekte të filluara dhe financuara nga anëtarët duke iu nënshtruar disponibilitetit të burimeve jofinanciare të Agjencisë.

Neni 6

Anëtarësimi

A. Anëtarësimi është i hapur për ato shtete që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik që kanë vullnetin dhe aftësinë për të vepruar në pajtim me objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në statut. Për të qenë i pranueshëm për anëtarësim në Agjenci, një organizatë rajonale ndërqeveritare e integrimit ekonomik duhet të përbëhet nga shtete sovraane, ku të paktën një prej të cilëve është anëtar i Agjencisë, dhe të cilit shtetet anëtare ia kanë transferuar kompetencën në të paktën një prej çështjeve brenda objektit të aktivitetit të Agjencisë.

B. Këto shtete dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik bëhen:

1. Anëtare themeluese të Agjencisë, nëse e kanë nënshkruar këtë statut dhe kanë depozituar instrumentin e ratifikimit.

2. Anëtare të tjera të Agjencisë duke depozituar një instrument aderimi, pasi aplikimi për anëtarësim është aprovuar. Anëtarësimi konsiderohet i aprovuar, nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim brenda tre muajve, pasi aplikimi t'u jetë dërguar anëtarëve. Në rastin e mosmarrëveshjes, vendimi për aplikimin merret nga asambleja, në pajtim me nenin 9 paragrafi H numri 1.

C. Në rastin e një organizate rajonale, ndërqeveritare të integrimit ekonomik, organizata dhe shtetet e saj anëtare vendosin për përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve, sipas këtij statuti. Organizata dhe shtetet e saj anëtare nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejta, duke përfshirë të drejtat e votës, sipas statutit njëkohësisht. Në instrumentet e ratifikimit ose aderimit, organizatat e përmendura më sipër deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e rregulluara nga ky statut. Këto organizata informojnë qeverinë depozituese për çdo modifikim përkatës dhe shtrirjen e kompetencave të tyre. Në rastin e votimit për çështjet brenda kompetencës së tyre, organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik votojnë me numrin e votave të barabartë me numrin e votave që u jepën shteteve të tyre anëtare që janë gjithashtu anëtare të Agjencisë.

Neni 7

Vëzhguesit

A. Statusi i vëzhguesit mund t'u jepet nga asambleja:

1. Organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare, që veprojnë në fushën e energjisë së rinovueshme;

2. Nënshkruesve që nuk e kanë ratifikuar statutin; dhe

3. Aplikuesve për anëtarësim, aplikimi për anëtarësim i të cilëve është pranuar në pajtim me nenin 6, paragrafi B, numri 2.

B. Vëzhguesit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote në sesionet publike të asamblesë dhe organeve në varësi të saj.

Neni 8 Organet

A. Themelohen si organe kryesore të Agjencisë:

1. Asambleja;
2. Këshilli;
3. Sekretariati.

B. Asambleja dhe këshilli, në pajtim me aprovimin e asamblesë, mund të themelojë organe të tilla varësie që ajo e shih të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj në pajtim me statutin.

Neni 9 Asambleja

A. 1. Asambleja është organi më i lartë i Agjencisë.

2. Asambleja mund të diskutojë çdo çështje brenda objektit të këtij statuti ose në lidhje me kompetencat dhe funksionet e çdo organi të parashikuara në këtë statut.

3. Për çdo çështje të tillë, asambleja mund të:

- a) marrë vendime dhe bëjë rekomandime për çdo organ të tillë; dhe
- b) bëjë rekomandime për anëtarët e Agjencisë, me kërkesë të tyre.

4. Për më tepër, asambleja ka autoritetin të propozojë çështje për shqyrtim nga këshilli dhe të kërkojë nga këshilli dhe sekretariati raporte mbi çdo çështje në lidhje me funksionimin e Agjencisë.

B. Asambleja përbëhet nga të gjithë anëtarët e Agjencisë. Asambleja takohet në sesione periodike që mbahen çdo vit, përveç kur ajo vendos ndryshe.

C. Asambleja përfshin një përfaqësues nga secili anëtar. Përfaqësuesit mund të shoqërohen nga zëvendës ose këshilltarë. Shpenzimet për pjesëmarrjen e delegacionit mbulohen nga anëtarët përkatës.

D. Sesionet e asamblesë zhvillohen në selinë e Agjencisë, përveç kur asambleja vendos ndryshe.

E. Në fillim të çdo sesioni periodik, asambleja zgjedh një president dhe ata zyrtarë të tjerë që kërkohen, duke pasur parasysh një përfaqësim të drejtë gjeografik. Ata qëndrojnë në detyrë derisa të zgjidhet presidenti i ri ose zyrtarë të tjerë në sesionin tjetër të radhës. Asambleja miraton rregullat e saj procedurale në pajtim me këtë statut.

F. Në pajtim me nenin 6, paragrafin C, secili anëtar i Agjencisë ka një votë në asamble. Asambleja i merr vendimet për çështjet procedurale me shumicë të thjeshtë që janë të pranishëm dhe votojnë. Vendimet mbi çështjet lëndore merren me konsensusin e anëtarëve të pranishëm. Nëse nuk arrihet konsensus, konsensusi konsiderohet i arritur, nëse nuk kundërshtojnë më shumë se 2 anëtarë, përveç kur statuti parashikon ndryshe. Kur ngrihet pyetja nëse çështja në diskutim është e natyrës lëndore apo jo, kjo trajtohet si çështje lëndore, përveç kur asambleja vendos ndryshe me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, që, nëse nuk arrihet konsensusi, konsiderohet të jetë arritur nëse nuk kundërshtojnë më shumë se dy anëtarë. Një shumicë e anëtarëve të Agjencisë përbën kuorumin e asamblesë.

G. Asambleja, me konsensusin e anëtarëve të pranishëm:

1. zgjedh anëtarët e këshillit;
2. miraton në sesionet e saj periodike buxhetin dhe programin e punës së Agjencisë, të paraqitur nga këshilli, dhe ka autoritetin të vendosë për ndryshimet në buxhet dhe programin e punës së Agjencisë;
3. merr vendime në lidhje me mbikëqyrjen e politikave financiare të Agjencisë, rregullave financiare dhe çështjeve të tjera financiare dhe zgjedh auditin;
4. miraton ndryshimet në këtë statut;
5. vendos mbi themelimin e organeve të varësisë dhe aprovon termat e referencës së tyre;
6. vendos mbi lejen për të votuar në pajtim me nenin 17 paragrafi A.

H. Asambleja me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, ku, nëse nuk mund të arrihet konsensus, ai konsiderohet i arritur nëse nuk kundërshtohet nga më shumë se 2 anëtarë:

1. vendos, sipas rastit, mbi aplikimet për anëtarësim;
2. aprovon rregullat procedurale të asamblesë dhe të këshillit, që paraqiten nga këta të fundit;
3. miraton raportin vjetor, si dhe raporte të tjera;
4. aprovon lidhjen e marrëveshjeve për çdo çështje brenda objektit të këtij statuti;
5. vendos në rastin e mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve të saj mbi projekte shtesë në pajtim me nenin 5 paragrafi B.

I. Asambleja cakton selinë e Agjencisë dhe drejtorin e përgjithshëm të sekretariatit (këtu quhet “Drejtor i Përgjithshëm”) me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, ose, nëse nuk mund të arrihet konsensus, me shumicën e votave prej dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

J. Asambleja shqyrton dhe aprovon, sipas rastit, në sesionin e parë çdo vendim, projekt-marrëveshje, dispozitë dhe udhëzim të zhvilluar nga komisioni përgatitor, në pajtim me procedurat e votimit për çështjen përkatëse që parashikohen në nenin 9 paragrafët F deri I.

Neni 10 Këshilli

A. Këshilli përbëhet nga të paktën 11, por jo më shumë se 21 përfaqësues të anëtarëve të Agjencisë, të zgjedhur nga asambleja. Numri konkret i përfaqësuesve ndërmjet 11 dhe 21 përputhet me ekuivalentin e rrumbullakosur të një të tretës së anëtarëve të Agjencisë, që llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve të Agjencisë në fillim të zgjedhjes përkatëse të anëtarëve të këshillit. Anëtarët e këshillit zgjidhen me bazë rotacioni sipas parashikimit në rregullat e procedurës së asamblesë, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së efektshme të vendeve në zhvillim dhe të zhvilluara dhe arritjen e një shpërndarjeje të drejtë dhe të barabartë gjeografike dhe efektiviteti në punën e këshillit. Anëtarët e këshillit zgjidhen për një afat prej dy vjetësh.

B. Këshilli mbledhet dy herë në vit dhe mbledhjet e tij zhvillohen në selinë e Agjencisë, përveç kur këshilli vendos ndryshe.

C. Këshilli, në fillim të çdo mbledhjeje dhe me efekt deri në mbledhjen tjetër, zgjedh një kryetar dhe ata zyrtarë të tjerë nga anëtarët e vet që mund të jenë të nevojshëm. Ai ka të drejtën e përpilimit të rregullave procedurale. Këto rregulla procedurale duhet të paraqiten në asamble për aprovim.

D. Çdo anëtar këshilli ka një votë. Këshilli i merr vendimet për çështjet procedurale me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të tij. Vendimet mbi çështjet lëndore merren me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij. Kur ngrihet pyetja nëse çështja në diskutim është e natyrës lëndore apo jo, kjo trajtohet si çështje lëndore, përveç kur këshilli vendos ndryshe me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij.

E. Këshilli është përgjegjës dhe raporton në asamble. Këshilli ushtron kompetencat dhe funksionet e besuara atij sipas këtij statuti, si dhe ato funksione që i delegohen atij nga asambleja. Për ta bërë këtë, ai vepron në pajtim me vendimet dhe duke marrë parasysh rekomandimet e asamblesë dhe siguron zbatimin e tyre të përshtatshëm dhe të vazhdueshëm.

F. Këshilli:

1. lehtëson konsultimet dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve;
2. shqyrton dhe paraqet në asamble projektprogramin e punës dhe projektbuxhetin e Agjencisë;
3. aprovon masat për sesionet e asamblesë duke përfshirë përgatitjen e projektaxhendës;
4. shqyrton dhe paraqet në asamble projektraportin vjetor, në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe raporte të tjera që përgatiten nga sekretariati, sipas nenit 11 paragrafi E numri 3 i këtij statuti;
5. përgatit çdo raport tjetër vjetor që mund të kërkojë asambleja;
6. lidh marrëveshje ose përgatit masa me shtete, organizata ndërkombëtare dhe agjenci ndërkombëtare në emër të Agjencisë, duke iu nënshtruar aprovimit paraprak të asamblesë;
7. realizon programin e punës të miratuar nga asambleja, me qëllim zbatimin e saj nga sekretariati dhe brenda kufijve të buxhetit të miratuar;
8. ka autoritetin t'i kalojë asamblesë çështje për shqyrtim, dhe
9. themelojë organe varësie, sipas rastit, në pajtim me nenin 8, paragrafi B, dhe të vendosë për termat e tyre të referencës dhe kohëzgjatjen.

Neni 11 Sekretariati

A. Sekretariati ndihmon asamblesë, këshillin dhe organet e tyre të varësisë në përmbushjen e funksioneve të tyre. Ai kryen funksione të tjera që i besohen atij sipas statutit, si dhe ato funksione që i delegohen atij nga asambleja ose këshilli.

B. Sekretariati përbëhet nga drejtori i përgjithshëm, që është drejtuesi i tij dhe përgjegjësi i administratës dhe personeli tjetër i nevojshëm. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga asambleja me rekomandim të këshillit për një afat prej katër vjetësh, të rinovueshëm për një mandat tjetër, por jo pas kësaj.

C. Drejtori i përgjithshëm është përgjegjës kundrejt asamblesë dhe këshillit, ndërmjet të tjerash, për emërimin e personelit, si dhe organizimin dhe funksionimin e sekretariatit. Shqyrtimi i kujdesshëm i punësimit të personelit dhe i caktimit të kushteve të shërbimit është i domosdoshëm për të siguruar standardet më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit. Duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur rëndësisë së rekrutimit të personelit kryesisht nga shtetet anëtare dhe me një bazë gjeografike sa më të gjerë që të jetë e mundur, duke marrë veçanërisht parasysh përfaqësimin e përshtatshëm të vendeve në zhvillim dhe duke theksuar balancën e gjinisë. Në përgatitjen e buxhetit, rekrutimi i propozuar drejtohet nga parimi që personeli të mbahet në nivelin minimal të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësisë të sekretariatit.

D. Drejtori i përgjithshëm ose një përfaqësues i caktuar prej tij ose saj, merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha takimet e asamblesë dhe të këshillit.

E. Sekretariati:

1. përgatit dhe i paraqet këshillit projektprogramin e punës dhe projektbuxhetin e Agjencisë;
2. zbaton programin e punës së Agjencisë dhe vendimet e saj;
3. përgatit dhe i paraqet këshillit projektraportin vjetor, në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe ato raporte të tjera që mund të kërkojë asambleja ose këshilli;
4. i jep asamblesë, këshillit dhe organeve të tyre të varësisë mbështetje administrative dhe teknike;
5. lehtëson komunikimin ndërmjet Agjencisë dhe anëtarëve të saj; dhe
6. qarkullon këshillimin mbi politikën, pasi t'u jetë dhënë anëtarëve të Agjencisë në pajtim me nenin 4 paragrafi C numri 2 dhe përgatit dhe paraqet në asamble dhe këshill një raport mbi këshillimin e tij mbi politikën për secilin prej sesioneve të tyre. Raporti në këshill përfshin edhe këshillimin e planifikuar mbi politikën në zbatimin e programit vjetor të punës.

F. Për përmbushjen e detyrave të tyre, drejtori i përgjithshëm dhe anëtarët e tjerë të personelit nuk kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë qeveri ose burim tjetër nga jashtë Agjencisë. Ata nuk kryejnë asnjë veprim që mund të ndikojnë në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë të përgjegjshëm ndaj Agjencisë dhe këshillit. Çdo anëtar respekton vetëm karakterin ndërkombëtar të përgjegjësisë të drejtorit të përgjithshëm dhe të anëtarëve të tjerë të personelit dhe nuk përpiqet të ndikojë në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre.

Neni 12 Buxheti

A. Buxheti i Agjencisë financohet nga:

1. kontributet e detyrueshme të anëtarëve të saj, që bazohen në shkallën e vlerësimeve të Kombeve të Bashkuara, që përcaktohen nga asambleja;

2. kontributet vullnetare; dhe

3. burime të tjera të mundshme

në pajtim me rregullat financiare të miratuara nga asambleja me konsensus, që parashikohen në nenin 9, paragrafi G, i këtij statuti. Rregullat financiare dhe buxheti sigurojnë një bazë të shëndoshë financiare të Agjencisë dhe sigurojnë zbatimin e efektshëm dhe efikas të aktiviteteve të Agjencisë, sipas përcaktimit në programin e punës. Kontributet e detyrueshme financiojnë aktivitetet financiare thelbësore dhe shpenzimet administrative.

B. Projektbuxheti i Agjencisë përgatitet nga sekretariati dhe i paraqitet këshillit për shqyrtim. Këshilli ia paraqet atë asamblesë me një rekomandim për aprovim ose ia kthen atë sekretariatit për rishikim dhe riparaqitje.

C. Asambleja cakton një audit të jashtëm që qëndron në detyrë për një periudhë prej katër vitesh dhe që është i përshtatshëm për rizgjedhje. Audit i parë qëndron në detyrë për një periudhë prej dy vitesh. Audit i shqyrton llogaritë e Agjencisë dhe bën ato vërejtje dhe rekomandime që mendohen të nevojshme, në lidhje me efikasitetin e menaxhimit dhe kontrolleve të brendshme financiare.

Neni 13

Zotësia juridike, privilegjet dhe imunitetet

A. Agjencia ka zotësi juridike ndërkombëtare. Në territorin e secilit anëtar dhe në pajtim me legjislacionin e tij të brendshëm, ai gëzon atë zotësi juridike të brendshme që mund të jetë i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj.

B. Anëtarët vendosin privilegjet dhe imunitetet në një marrëveshje të veçantë.

Neni 14

Marrëdhëniet me organizatat e tjera

Pas aprovimit të asamblesë, këshilli autorizohet të lidhë marrëveshje në emër të Agjencisë duke vendosur marrëdhënie të përshtatshme me Kombet e Bashkuara dhe çdo organizatë tjetër ndërkombëtare, puna e së cilës lidhet me atë të Agjencisë. Dispozitat e këtij statuti nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e asnjë anëtari që rrjedhin nga një traktat ekzistues ndërkombëtar.

Neni 15

Ndryshimet dhe tërheqja, rishikimi

A. Ndryshimet në këtë statut mund të propozohen nga çdo anëtar. Kopje të vërtetuara të tekstit të çdo ndryshimi të propozuar përgatiten nga drejtori i përgjithshëm dhe u komunikohen të gjithë anëtarëve të paktën nëntëdhjetë ditë para shqyrtimit nga asambleja.

B. Ndryshimet hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët:

1. Kur aprovohen nga asambleja pas shqyrtimit të vërejtjeve të bëra nga këshilli për çdo ndryshim të propozuar; dhe

2. Pasi të gjithë anëtarët të kenë dhënë pëlqimin për t'iu nënshtruar ndryshimit, në pajtim me proceset e tyre përkatëse kushtetuese. Anëtarët shprehin pëlqimin e tyre përkatës duke depozituar një instrument përkatës te depozituesi i përmendur në nenin 20, paragrafi A.

C. Në çdo kohë pas pesë vitesh nga data kur hyn në fuqi ky statut në pajtim me paragrafin D të nenit 19, një anëtar mund të tërhiqet nga Agjencia me anë të njoftimit me shkrim për këtë qëllim, të paraqitur depozituesit të përmendur në nenin 20, paragrafi A, që njofton menjëherë këshillin dhe të gjithë anëtarët.

D. Kjo tërheqje hyn në fuqi në fund të vitit në të cilin shprehet. Tërheqja e një anëtari nga Agjencia nuk cenon detyrimet e tij kontraktuale që janë marrë përsipër në pajtim me nenin 5, paragrafi B ose detyrimet e tij financiare për vitin në të cilin ai tërhiqet.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

A. Anëtarët zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij statuti me mjete paqësore në pajtim me nenin 2 paragrafi 3 i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe, për këtë qëllim, kërkojnë një zgjidhje me mjetet e treguara në nenin 33, paragrafi 1 i Kartës së Kombeve të Bashkuara.

B. Këshilli mund të kontribuojë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me çdo mjet që ai e konsideron të përshtatshëm, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të tij, duke u bërë thirrje anëtarëve në mosmarrëveshje të fillojnë procesin e zgjidhjes sipas zgjedhjes së tyre dhe duke rekomanduar një afat kohor për çdo procedurë të rënë dakord.

Neni 17

Pezullimi i përkohshëm i të drejtave

A. Çdo anëtar i Agjencisë, që është në vonesë në dhënien e kontributeve financiare Agjencisë, nuk ka të drejtë vote, nëse vonesat arrijnë ose tejkalojnë shumën e kontributeve të tij për dy vitet e mëparshme. Megjithatë, asambleja mund ta lejojë këtë anëtar të votojë, nëse është e bindur që mospagesa është për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të anëtarit.

B. Një anëtar që ka shkelur vazhdimisht dispozitat e këtij statuti ose të një marrëveshjeje të lidhur prej tij në pajtim me këtë statut mund të pezullohet nga ushtrimi i privilegjeve dhe të drejtave të anëtarësisë nga asambleja duke vepruar me shumicën prej dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë me rekomandim të këshillit.

Neni 18 **Selia e Agjencisë**

Selia e Agjencisë përcaktohet nga asambleja në sesionin e saj të parë.

Neni 19 **Nënshkrimi, ratifikimi, hyrja në fuqi dhe aderimi**

A. Ky statut është i hapur për nënshkrim në Konferencën Themeluese nga të gjitha shtetet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integritit ekonomik, siç përcaktohet nga neni 6 paragrafi A. Ajo mbetet e hapur për nënshkrim deri në datën që hyn në fuqi ky statut.

B. Për shtetet dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integritit ekonomik sipas përcaktimit në nenin 6 paragrafi A që nuk e kanë nënshkruar këtë statut, ky statut është i hapur për aderim pasi anëtarësimi i tyre të jetë aprovuar nga asambleja në pajtim me nenin 6 paragrafi B numri 2.

C. Pëlqimi për t'iu nënshtruar këtij statuti shprehet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të ratifikimit ose aderimit te depozituesi. Ratifikimi ose aderimi në këtë statut realizohet nga shtetet në pajtim me proceset e tyre përkatëse kushtetuese.

D. Ky statut hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pa datës së depozitimit të instrumentit të njëzet e pestë të ratifikimit.

E. Për shtetet ose organizatat rajonale ndërqeveritare të integritit ekonomik që kanë depozituar një instrument ratifikimi ose aderimi pas hyrjes në fuqi të statudit, ky statut hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit përkatës.

F. Asnjë rezervë nuk mund t'u bëhet dispozitave që gjenden në këtë statut.

Neni 20 **Depozituesi, regjistrimi, teksti autentik**

A. Qeveria e Republikës Federale Gjermane caktohet si depozituese e këtij statuti dhe çdo instrumenti të ratifikimit ose aderimit.

B. Ky statut regjistrohet nga qeveria depozituese në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

C. Ky statut, i bërë në gjuhën angleze, depozitohet në arkivat e qeverisë depozituese.

D. Kopje të vërtetuara rregullisht të këtij statuti u transmetohen nga qeveria depozituese qeverive të shteteve dhe organeve ekzekutive të organizatave rajonale ndërqeveritare të integritit ekonomik që e kanë nënshkruar ose janë aprovuar për anëtarësim sipas nenit 6 paragrafi B numri 2.

E. Qeveria depozituese informon menjëherë të gjithë nënshkruarit e këtij statuti për datën e çdo depozitimi të instrumentit të ratifikimit dhe datës së hyrjes në fuqi të statudit.

F. Qeveria depozituese informon menjëherë të gjithë nënshkruarit dhe anëtarët për datat në të cilat shtetet ose organizatat rajonale ndërqeveritare të integritit ekonomik bëhen më vonë anëtare të saj.

G. Qeveria depozituese dërgon menjëherë kërkesat për anëtarësim tek të gjithë anëtarët e Agjencisë për shqyrtim sipas nenit 6 paragrafi B, numri 2.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë statut.

Bërë në Bon, më 26 janar 2009, në një kopje origjinale të vetme, në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr. 10 232, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS SË MBIKALIMIT TË DURRËSIT””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6440, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE
FONDI SAUDIT PËR ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRTIMI I PROJEKTIT TË RRUGËS SË MBIKALIMIT NË DURRËS
NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE

HUAJA NR. : /
NËNSHKRUAR MË: 1430 A.H.
QË PËRPUTHET ME: 2009 A.D.

(Projekti përfundimtar pas diskutimeve ndërmjet palëve në Riad nga 4 deri 6.7.2009)

HUAJA NR. : ../...

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 1430 A.H. që përputhet me 2009 A.D.
Ndërmjet:

- 1) FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (këtu quhet Fondi), i përfaqësuar nga SH.T Eng. Yousef Ibrahim AL-bassam, zëvendëskryetar dhe drejtor menaxher ; dhe
- 2) KËSHILLIT TË MINISTRAVE, (këtu quhet Huamarrësi) i përfaqësuar nga SH.T., Ministër i Financave.

PREAMBUL

A) Ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar Fondit t'i japë një hua për të ndihmuar në financimin e ndërtimit të projektit të rrugës së mbikalimit (Bypass) të Durrësit, të përshkruar në grafikun nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (këtu të quajtur Projekti);

B) Ndërsa Huamarrësi ka marrë nga Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab (këtu të quajtur KFAED), një hua në një shumë të barabartë me (6 000 000) dinarë kuvajtianë për të ndihmuar në financimin e fazës së parë të projektit, sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së huasë të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe KFAED-it (këtu të quajtur Marrëveshja e huasë e KFAED-it);

C) Ndërsa qëllimi i Fondit është ndihmesa për vendet në zhvillim për të zhvilluar ekonomitë e tyre dhe për t'u dhënë atyre huatë e kërkuara për zbatimin e projekteve dhe programeve të zhvillimit të tyre;

D) Ndërsa Fondi është i bindur për rëndësinë e projektit dhe efektet e tij përfituese për zhvillimin ekonomik të popullit paqësor të Shqipërisë; dhe

E) Ndërsa bordi i drejtorëve të Fondit ka rënë dakord, duke pasur parasysh sa më sipër, nëpërmjet rezolutës së tij nr. 11/94/1107 për t'i dhënë Huamarrësit një hua sipas termave dhe kushteve të parashikuara këtu,

prandaj, këto palë, nëpërmjet kësaj, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përkufizime

Seksioni 1.01. Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e huasë të Fondit, të nxjerra me rezolutë të bordit të drejtorëve të fondit nr. 11/14 të datës Rajab 29, 1396 AH që përputhet me 26 korrik 1976 AD, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përfshirë tërësisht këtu (këto kushte të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e huasë të Fondit që këtu quhen kushte të përgjithshme).

Seksioni 1.02. Kur përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e përkufizuar në kushtet e përgjithshme dhe në preambulën e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të parashikuara në të, dhe termi "Ministria" është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve të Huamarrësit.

Neni 2

Huaja

Seksioni 2.01. Fondi bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve në Marrëveshjen e huasë të parashikuara ose të përmendura, një hua në një shumë prej dyzet e pesë milionë (45 000 000) Saudi Riyals.

Seksioni 2.02. Huamarrësi ka të drejtë ta tërheqë shumën nga llogaria e huasë në pajtim me dispozitat e grafikut nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, me ndryshimet e herëpashershme të grafikut me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit dhe në pajtim me procedurat për tërheqjet e fondit audit për huatë e zhvillimit, për shpenzimet e bëra ose, (nëse Fondi bie dakord) që duhet të bëhen në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe që duhet të financohen nga shumat e huasë.

Seksioni 2.03. Huamarrësi merr përsipër të përdorë shumat e huasë vetëm për financimin e koston së arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për realizimin e projektit. Prokurimi i këtyre mallrave, punëve dhe shërbimeve është në pajtim me udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe kontraktimin për ekzekutimin e punëve dhe përdorimin e konsulentëve të institucioneve të zhvillimit, anëtare të grupit të bashkëpunimit. Huamarrësi merr aprovimin e Fondit para dhënies së kontratave që duhet të financohen nga shumat e huasë dhe para kryerjes së çdo ndryshimi thelbësor të ardhshëm për secilën prej tyre.

Seksioni 2.04. Data e mbylljes është 31.12.2014 ose një datë e mëvonshme që mund të përcaktohet nga Fondi. Fondi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.05. Huamarrësi paguan një tarifë huaje me një normë dy për qind (2%) në vit mbi shumën principale të huasë së tërhequr dhe që nuk është e shlyer herë pas here.

Seksioni 2.06. Tarifa e huasë dhe detyrimet e tjera paguhen dy herë në vit, më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. Periudha e huasë është (25) vjet duke përfshirë një periudhë pa interesa prej (5) vjetësh. Huamarrësi shlyen shumën kryesore të huasë në pajtim me grafikun e amortizimit të përcaktuar në grafikun nr.3 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo kështë paguhet së bashku me detyrimin e huasë dhe detyrime të tjera duke bërë një njoftim (45) ditor që i drejtohet Huamarrësit nga Fondi para datës së kërkueshme.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01. a) Huamarrësi e zbaton projektin, nëpërmjet ministrisë, me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në pajtim me praktikën e përshtatshme administrative, financiare dhe inxhinierike dhe siguron, sapo të jenë të nevojshme, fondet, mjetet, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkohen për zbatimin e projektit.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi: 1) ofron menjëherë, sapo të jenë të nevojshme, të gjitha fondet e tjera që mund të kërkohen për realizimin e projektit (duke përfshirë çdo fond që mund të kërkohet për të përmbushur çdo rritje në koston e tij përtej koston së parashikuar në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje; nëse këto shuma janë ofruar nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Huamarrësit dhe një pale të tretë, termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të pranueshme për Fondin; 2) bën caktimet e përshtatshme buxhetore vjetore për të përmbushur pjesët e veta të koston së projektit; dhe 3) mbështet çdo shpenzim tjetër që kalon shumën e huasë dhe që është e nevojshme për arritjen e projektit.

Seksioni 3.02. Huamarrësi i kërkon ministrisë t'i paraqesë Fondit, menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, raportet, dokumentet e kontratave dhe grafikët e ndërtimit dhe prokurimit për projektin dhe çdo modifikim të tij ose shtesë me ato hollësi që Fondi i kërkon në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 3.03. Për mbikëqyrjen e ekzekutimit të projektit, Huamarrësi ka inxhinierë konsulentë, kualifikimet dhe eksperiencat e të cilëve janë të pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.04. Në përmbushjen e projektit, Huamarrësi angazhon kontraktues të pranueshëm për Fondin me termat dhe kushtet e pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.05. Huamarrësi merr masa që mallrat e importuara që financohen nga shumata e huasë të sigurohen nga rreziqet në lidhje me blerjen, transportin dhe furnizimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit dhe për këtë sigurim çdo kompensim paguhet në një monedhë që është lirisht e përdorshme nga Huamarrësi për të zëvendësuar ose riparuar mallrat.

Seksioni 3.06. Huamarrësi siguron që të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga shumata e huasë të përdoren vetëm për zbatimin e projektit.

Seksioni 3.07. Huamarrësi i kërkon ministrisë që:

a) të mbajë regjistra të përshtatshëm për të regjistruar ecurinë e projektit (duke përfshirë koston e tij), për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumata e huasë dhe për të pasqyruar përdorimin e tyre në projekt dhe për të reflektuar të gjitha operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin;

b) t'u japë të gjithë mundësinë e arsyeshme përfaqësuesve të Fondit për të bërë vizita për qëllimet në lidhje me huanë, të inspektojnë projektin, mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumata e huasë dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës;

c) t'i japë Fondit të gjithë atë informacion, që Fondi e kërkon në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me projektin, shpenzimin e shumave të huasë dhe mallrat dhe shërbimet e financuara nga këto shuma.

Seksioni 3.08. Huamarrësi i kërkon ministrisë të ndërmarrë të gjitha ato veprime që do të jenë të nevojshme për të përfutur siç dhe kur kërkohet tokë dhe ato të drejta mbi tokën që kërkohen për zbatimin e projektit.

Neni 4

Detyrime të veçanta

Seksioni 4.01. a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë pëlqimin e tyre që asnjë detyrim tjetër i jashtëm nuk do të ketë prioritet mbi huanë nëpërmjet një barre të vendosur mbi sendet pasurore qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, përveç kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse

vendoset një barrë në ndonjë send pasuror të Huamarrësit si garanci për një detyrim të jashtëm, kjo barrë garanton *ipso facto* dhe pa shpenzime për Fondin në mënyrë të barabartë dhe të vlerësueshme pagesën e shumës kryesore të huasë, tarifën e huasë dhe çdo detyrim tjetër mbi huanë dhe që në vendosjen e çdo barre të tillë bëhet parashikim shprehimisht për këtë qëllim.

b) Detyrimi i parashikuar në paragrafin (a) të këtij seksioni nuk zbatohet për:

i) çdo barrë të vendosur mbi pasuri, në momentin e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie;

ii) çdo barrë mbi mallrat tregtare për të garantuar një detyrim që maturohet jo më vonë se një vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht dhe duhet të paguhet nga shumat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

iii) çdo barrë që lind gjatë kryerjes së zakonshme të transaksioneve bankare dhe sigurimit të një detyrimi që maturohet jo më vonë se një vit pas datës së tij.

Seksioni 4.02. Huamarrësi mban ose kërkon të mbahen regjistra të përshtatshëm për të reflektuar në pajtim me praktikën e shëndosha të kontabilitetit, operacionet, burimet dhe shpenzimet, në lidhje me projektin e ministrisë dhe departamenteve të tjera ose agjencive të Huamarrësit, përgjegjëse për zbatimin e projektit ose pjesë të tij.

Seksioni 4.03. Huamarrësi lidh siguracion për projektin për këto rreziqe dhe në ato shuma që janë në pajtim me praktikën e përshtatshme, në përputhje me rregulloren në fuqi në vendin e vet.

Seksioni 4.04. Huamarrësi merr përsipër të bëjë një tabelë kujtese, me dimensione të përshtatshme, të përbërë nga betoni ose metal tjetër të përshtatshëm që duhet të vendoset në një vend të dukshëm në një nga ambientet e përfshira në projekt, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e projektit.

Seksioni 4.05. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë mirëmbajtjen e përgjithshme duke realizuar inspektimin periodik, në pajtim me principet e përshtatshme inxhinierike dhe për të parashikuar caktimet e nevojshme për këtë qëllim në buxhetin vjetor. Huamarrësi merr përsipër gjithashtu t'i paraqesë Fondit planet e miratuara për mirëmbajtje, siç mund t'i kërkojë Fondi.

Seksioni 4.06. Huamarrësi merr përsipër të kryejë çdo modifikim në projekt vetëm me aprovimin paraprak të Fondit.

Seksioni 4.07. Huamarrësi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që dimensionin dhe ngarkesat me akse të automjeteve që përdorin rrugën, të mos kalojnë kufijtë që respektojnë standardet e projektimit strukturor dhe gjeometrik të rrugës.

Seksioni 4.08. Menjëherë pas përfundimit të projektit, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit, ose në një datë të mëvonshme që mund të bjerë dakord Fondi për këtë qëllim, Huamarrësi përgatit dhe i paraqet Fondit një raport për përfundimin e projektit, në formë të arsyeshme dhe të detajuar siç e kërkon Fondi, mbi zbatimin dhe operimin fillestar të projektit, shpenzimet e tij dhe përfitimet e përfuara dhe që do të përftohen prej tij, përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas marrëveshjes së huasë dhe arritjen e objektivave të huasë.

Neni 5

Mjetet në dispozicion të Fondit

Seksioni 5.01. Për qëllimet e seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme, ngjarjet e mëposhtme shtesë përcaktohen në pajtim me paragrafin (f) të tij:

a) Në pajtim me nënseksionin (b) të këtij seksioni:

i) e drejta e Huamarrësit për t'i tërhequr shumat e çdo huaje ose granti të dhënë Huamarrësit për financimin e projektit pezullohet, anulohet ose pushohet plotësisht ose pjesërisht, në pajtim me termat e marrëveshjes që e parashikon atë, ose

ii) çdo hua e tillë bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme para maturimit të rënë dakord për të.

b) Nënseksioni (a) i këtij seksioni nuk zbatohet nëse Huamarrësi provon në mënyrë të pranueshme për Fondin që (i) ky pezullim, anulim, pushim ose paramaturim nuk shkaktohet nga mospërmbushja nga ana e Huamarrësit e ndonjë prej detyrimeve të tij, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, dhe (ii) për projektin Huamarrësit i janë vënë në dispozicion fonde të mjaftueshme nga burime të tjera me termat dhe kushtet në pajtim me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Për qëllimet e seksionit 7.01 të kushteve të përgjithshme, ngjarja e mëposhtme përcaktohet në pajtim me paragrafin (d) të tij, d.m.th., që ngjarja e përcaktuar në nënseksionin (a) (ii) të

seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon për një periudhë më të gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data në të cilën Fondi vë në dijeni Huamarrësin për ndodhinë e ngjarjes së sipërpërmendur.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi – Prishja e Marrëveshjes

Seksioni 6.01. Periudha prej (6) muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave të Huamarrësit emërohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimin e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

PËR FONDIN

Fondi Saudit për Zhvillimin
P.O.Box 50483
Riad 11523
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel: +966-1-2794000
Telefax : +966-1-4647450
E-mail: info@sfd.gov.sa
Swift:

PËR HUAMARRËSIN

1. Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit nr.1
Tirana, Republika e Shqipërisë
Tel: + 35542228405
Telefax: + 35542228494

2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Sheshi Skenderbej nr.5
Tirana, Republika e Shqipërisë
Tel: + 35542234647
Telefax : + 35542232389

Në dëshmi të kësaj, këto palë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit e tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në emrat e tyre përkatës, në qytetin e Tiranës, në ditën, muajin dhe vitin e përmendur më sipër, në dy kopje në gjuhët arabe dhe angleze, secila prej të cilave është një ekzemplar origjinal dhe një kopje e kushteve të përgjithshme në të dy gjuhët që i jepet Huamarrësit. Nëse një dispozitë e versionit arab të Marrëveshjes së Huasë dhe/ose kushteve të përgjithshme është në mospajtim me një dispozitë të versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë dhe/ose kushteve të përgjithshme, përkatësisht, mbizotëron versioni arab.

PËR FONDIN SAUDIT TË ZHVILLIMIT
Yousef Ibrahim Al-bassam
Zëvendëskryetar dhe drejtor menaxher

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

GRAFIKU NR.1
TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUASË

A) Tabela e mëposhtme parashikon kategoritë e artikujve që financohen nga shumat e huasë, caktimin e shumës së huasë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që duhet të financohen për çdo kategori.

Kategoria		Shuma e huasë e caktuar (Shprehur në Saudi Riyals)	Përqindje e shpenzimeve që duhet të financohen
1	Ndërtimi i mbikalimit dhe kanalit të kullimit (Pjesa e fazës së dytë të projektit)	40 000 000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
2	Shërbimet e konsulencës dhe mbikëqyrja (Pjesa e fazës së dytë të projektit)	2 000 000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
3	Të pacaktuara	3 000 000	
Totali :		45 000 000	

B) Pavarësisht dispozitave të paragrafit (A) të mësipërm, asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me pagesat e bëra për:

- 1) Shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje;
- 2) Tatimet e mbledhura nga ose në territorin e Huamarrësit për mallrat ose shërbimet, ose për importimin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre.

C) Pavarësisht nga caktimi i një shume të huasë ose përqindjeve të disbursimit të parashikuar në tabelën e paragrafit (A) të mësipërm, nëse Fondi ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme që shumat e huasë që është caktuar në një kategori do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord për të gjitha shpenzimet e asaj kategorie, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, mund:

i) të ricaktojë për këtë kategori, në masën që kërkohet për të përmbushur diferencën e parashikuar, shumat e huasë që nuk janë caktuar deri atëherë dhe që, sipas mendimit të Fondit, nuk nevojiten për të mbuluar shpenzime të tjera; dhe

ii) nëse një ricaktim i tillë nuk mund të mbulojë diferencën e parashikuar, të ulë përqindjen e disbursimit që zbatohet për këto shpenzime, me qëllim që të mund të vazhdojnë tërheqjet sipas kësaj kategorie derisa të mbulojnë të gjitha shpenzimet e bëra atje.

GRAFIKU NR. 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon të fuqizojë zhvillimin ekonomik dhe social në veri dhe qendër të Shqipërisë duke përmirësuar shërbimet e qarkullimit rrugor për të përmbushur kërkesën në rritje.

Projekti përbëhet nga fazat e mëposhtme:

FAZA E PARË: Ndërtimi i një rruge të re përgjatë rrugës ekzistuese me një gjatësi të përgjithshme prej 5 km; rruga kryesore përbëhet nga dy korsitë për secilin drejtim me ishull të brendshëm, rrugët e shërbimit, trotuare, instalimet e mbrojtjes dhe ndriçimit.

FAZA E DYTË: Ndërtimi i përforcimit të mbikalimit prej betoni në Rrethrotullimin e Durrësit me një gjatësi totale prej 320 m. Edhe ndërtimi i përforcimit të kanalit të kullimit të përforcimit për derdhjen e ujit në të gjithë drejtimin e rrugës me gjatësi prej 1 km, përveç trotuareve dhe instalimeve të ndriçimit; duke përfshirë shërbimet e konsulencës dhe mbikëqyrjes.

E gjithë kostoja e projektit është rreth € (24) milionë që është e barabartë me rreth SR (132) milionë. Projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2013.

GRAFIKU NR.3
GRAFIKU I AMORTIZIMIT

Kësti nr.	Data e pagesës	Shuma e këstit e shprehur në Saudi Riyals
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		
11.		
12.		
13.		
14.		
15.		
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		
22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		
28.		
29.		
30.		
31.		
32.		
33.		
34.		
35.		
36.		
37.		
38.		
39.		
40.		
TOTALI		45 000 000

LIGJ
Nr.10 233, datë 11.2.2010

PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, që në vijim do të quhet “Autoriteti”.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

KREU II
STATUSI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 3
Statusi i Autoritetit

Autoriteti është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, në vijim ministri.

Neni 4
Organet drejtuese të Autoritetit

Organet drejtuese të Autoritetit janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

Neni 5
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit.

2. Këshilli drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët dy specialistë të fushës së transportit ajror, dy specialistë të fushës së financës dhe një specialist i fushës ligjore.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues emërohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 6

Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- a) miraton programet e zhvillimit të Autoritetit, në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;
- b) propozon te ministri strukturën organizative të Autoritetit dhe strukturën e pagave që do të zbatohet;
- c) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorive, të departamenteve, nëpunësve dhe punonjësve të tjerë;
- ç) miraton kriteret e propozuara nga drejtori ekzekutiv, që do të zbatohen për punësimin e personelit të Autoritetit;
- d) analizon dhe propozon për miratim te ministri programin financiar të Autoritetit, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar periodikisht realizimin e tij;
- dh) propozon te ministri masën e tarifave, që do të zbatohen nga Autoriteti, sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe të Ministrisë të Financave;
- e) merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Kriteret e emërimit të anëtarëve të këshillit drejtues

Për t'u emëruar anëtarë të këshillit drejtues, personat duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë arsim të lartë;
- c) të kenë përvojë, të paktën 5 vjet, në administratën publike ose në institucionet shkencore arsimore;
- ç) të jenë me integritet moral dhe profesional;
- d) të jenë të paangazhuar në funksione drejtuese partiake;
- dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale;
- e) të mos jenë të përjashtuar nga shërbimi civil;
- ë) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Mandati i anëtarëve të këshillit drejtues

1. Mandati i kryetarit të këshillit drejtues është 4 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje për një mandat të dytë, ndërsa ai i anëtarëve është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.
2. Kur mandati i kryetarit ose i anëtarit përfundon, ata qëndrojnë në detyrë deri në çastin e emërimit të kryetarit ose të anëtarit të ri. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtarit të këshillit drejtues, Autoriteti lajmëron, me shkrim, ministrin, i cili fillon praktikën për emërimin e anëtarit të ri.
3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një këshilli drejtues apo të një organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Neni 9

Shpërblimet e këshillit drejtues

Kryetari dhe anëtarit i këshillit drejtues shpërblehen në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Lirimi nga detyra i anëtarit të këshillit drejtues

1. Lirimi nga detyra i anëtarit të këshillit drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet kur:
 - a) jep dorëheqjen;

- b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
 - c) kur mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;
 - ç) i shkakton, për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës, dëm Autoritetit apo imazhit të këtij autoriteti;
 - d) vepron, gjatë ushtrimit të funksioneve, në kundërshtim me interesat e Autoritetit;
 - dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
 - e) humbet apo lë shtetësinë shqiptare.
2. Propozimi për lirim nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues i paraqitet ministrit nga vetë këshilli apo nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit, shoqëruar edhe me arsyet e provat, për të cilat kërkohet ky lirim.
3. Ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit.
4. Kur ndonjëri prej anëtarëve të këshillit drejtues lirohet nga detyra përpara përfundimit të mandatit, anëtari tjetër emërohet sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për emërimin e anëtarëve të këtij këshilli.

Neni 11

Mbledhjet e këshillit drejtues

1. Mbledhjet e këshillit thirren me nismën e kryetarit, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit. Këshilli drejtues mbledhet të paktën një herë në dy muaj për të diskutuar e vendosur për rendin e ditës.
2. Mbledhjet e këshillit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.
3. Këshilli në mbledhjen e parë miraton rregulloren për organizimin e punës.
4. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë dhe vendimet e tij janë të vlefshme, kur votojnë pro të paktën 3 anëtarë. Në votim nuk lejohet abstenimi.
5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit nënshkruhen nga kryetari.

Neni 12

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i Autoritetit, i cili emërohet nga ministri.
2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues.
3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit pa të drejtë vote.

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

- a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit;
- b) paraqet për miratim në këshillin drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;
- c) paraqet për miratim në këshillin drejtues buxhetin dhe programin përkatës të punës përpara fillimit të çdo veprimtarie;
- ç) harton dhe paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomik-financiar të Autoritetit, si dhe vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha autorizimet, certifikimet dhe licencat që lëshon ky Autoritet;
- d) përcakton dhe paraqet për miratim në këshillin drejtues kërkesat për çdo pozicion pune, kriteret e punësimit të personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përparësitë e Autoritetit dhe me rregulloren e tij të brendshme;
- dh) emëron personelin e nevojshëm, sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe administron burimet njerëzore e kualifikimet tyre;

- e) përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet me të tretët;
- ë) ushtron të gjitha detyrat e Autoritetit, në zbatim të Kodit Ajror dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licencat e kategorizimet.

Neni 14

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë arsim të lartë;
- c) të ketë përvojë, të paktën 5 vjet, në administratën publike në fushën e menaxhimit, administrimit dhe të jurisprudencës;
- ç) të ketë integritet moral dhe profesional;
- d) të jetë i paangazhuar në funksione drejtuese partiake;
- dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;
- e) të mos jetë përjashtuar nga shërbimi civil;
- ë) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 15

Lirimi nga detyra i drejtorit ekzekutiv

Ministri vendos lirimin nga detyra të drejtorit ekzekutiv në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se 3 muaj për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar;
- c) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës, i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të institucionit;
- ç) vepron, gjatë ushtrimit të funksioneve, në kundërshtim me interesat e Autoritetit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
- dh) humbet apo lë shtetësinë shqiptare.

KREU III

ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Neni 16

Organizimi dhe detyrimet

1. Struktura organizative dhe struktura e pagave të administratës së Autoritetit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
2. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e Autoritetit rregullohen sipas Kodit të Punës.
3. Rekrutimi i nëpunësve të Autoritetit bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës, të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës.
4. Nuk mund të punësohen në strukturat e Autoritetit personat:
 - a) e dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;
 - b) ortakë apo aksionarë të subjekteve të mbikëqyrura;
 - c) që kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “b” të kësaj pike me anëtarët e këshillit drejtues apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje varësie;
 - ç) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional;
 - d) për të cilët është marrë masa disiplinore e largimit nga puna.

Neni 17
Të ardhurat e Autoritetit

1. Të ardhurat realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti në bazë të kostos.
2. Të ardhurat e Autoritetit përfshijnë:
 - a) të ardhurat nga tarifat e rrugës (en-route), të cilat mblidhen dhe faturohen nga Eurokontrolli, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët të lidhur për tarifat e rrugës (en-route);
 - b) të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, e cila merret nëpërmjet aeroportit;
 - c) të ardhurat nga tarifa e sigurisë në fluturim, e cila merret nga operatorët ajrorë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) të ardhurat nga autorizimet, licencimet dhe certifikimet e parashikuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë;
 - d) të ardhurat nga sanksionet në zbatim të legjislacionit në fuqi;
 - dh) të ardhura të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Pasqyrat financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve hartohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të aviacionit civil.
5. Autoriteti, për përdorimin e fondeve të veta, zbaton dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimet publike.
6. Autoriteti, me autorizimin e ministrit, ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje kredie me institucione bankare, për të realizuar veprimtarinë.
7. Autoriteti është i përjashtuar nga të gjitha taksat dhe tatimet e drejtpërdrejta.

Neni 18
Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.
2. Autoriteti, nëpërmjet këshillit drejtues, i paraqet për miratim ministrit një program të hollësishëm financiar për vitin pasardhës, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit.
3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim fondet e papërdorura derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 19
Kontabiliteti

1. Autoriteti mban regjistrat kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kontabël të zbatueshme.
2. Regjistrat kontabël duhet të pasqyrojnë me saktësi, në çdo kohë, gjendjen financiare të Autoritetit.
3. Autoriteti përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe, pas certifikimit nga ekspertët auditues, i raporton ministrit rezultatin financiar.

Neni 20
Raportimi nga Autoriteti

1. Në muajin prill të vitit pasardhës Autoriteti i paraqet ministrit:
 - a) një raport vjetor për veprimtarinë e tij, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga këshilli drejtues;
 - b) pasqyrën financiare vjetore;
 - c) një raport për realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve;

ç) një raport për licencat e dhëna, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave apo për kërkesat e tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, si dhe për të dhënat e regjistrave.

2. Autoriteti i paraqet ministrin, në çdo kohë, me kërkesë të tij, çdo të dhënë tjetër, që vlerësohet e nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të transportit ajror.

KREU IV KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 21 **Kodi etik dhe profesionalizmi**

1. Anëtarët e këshillit drejtues, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale, të miratuara nga këshilli.

2. Kur vërehen shkelje të kodit të etikës ose mungesë profesionalizmi, merren masa disiplinore deri në lirim ose largimin nga detyra.

Neni 22 **Konfidencialiteti**

1. Të dhënat për veprimtarinë e subjekteve, që operojnë në fushën e aviacionit civil, të cilat i vihen në dispozicion Autoritetit, klasifikohen “konfidenciale”, nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose reputacionin e subjektit.

2. Nuk janë “konfidenciale” të dhënat tregtare, të siguruar nga subjektet, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera.

3. Anëtarët e këshillit drejtues, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t’i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë të dhënat “konfidenciale”.

4. Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative, deri në lirim nga detyra të anëtarit të këshillit ose largimin nga detyra të nëpunësit të Autoritetit.

KREU V KOMPETENCA E AUTORITETIT PËR ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Neni 23 **Marrja e masave administrative ndaj subjekteve të treta**

1. Drejtori ekzekutiv merr vendime për:

a) parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve, që përbëjnë shkelje të Kodit Ajror dhe të akteve ligjore të dala në zbatim të tij;

b) parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit;

c) shmangien e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit.

2. Në vendimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni përcaktohen:

a) veprimet që duhet të kryejnë subjektet, për të parandaluar dëmin apo për të korrigjuar gjendjen;

b) afatet për kryerjen e ndryshimeve apo për korrigjimin e veprimeve;

c) detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve, në rastet kur veprimet bien në kundërshtim me ligjin.

3. Autoriteti, në përputhje me parashikimet e neneve 142 e 143 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, mund të zbatojë masë administrative vënien e gjobave.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 24

Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

1. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji përfundojnë kompetencat vendimmarrëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil (DPAC).
2. Të gjitha mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të DPAC-së, me shkrirjen e këtij institucioni, i kalojnë Autoritetit.
3. Tarifat e zbatuara deri tani nga DPAC-ja mbeten në fuqi dhe zbatohen nga Autoriteti deri në miratimin e tarifave të reja, sipas shkronjës “dh” të nenit 6 të këtij ligji.
4. Me fillimin e vitit të parë financiar, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të ardhurat e parashikuara në nenin 17 të këtij ligji të derdhen në llogarinë e Autoritetit.

Neni 25

Emërimi i organeve të para drejtuese

Brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministri emëron drejtorin ekzekutiv dhe propozon anëtarët dhe kryetarin e këshillit drejtues të Autoritetit.

Neni 26

Mbarimi i funksioneve dhe shkrirja e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil

1. Brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji:
 - a) administrata e DPAC-së shkrirhet;
 - b) drejtori ekzekutiv, sipas procedurave të miratuara nga këshilli drejtues, fillon punën për rekrutimin e nëpunësve dhe të punonjësve të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në DPAC;
 - c) personat, që ushtrojnë funksione ekzekutive në administratën e DPAC-së, nuk kanë më asnjë kompetencë vendimmarrëse për lëshimin e licencave apo për zgjatjen e afateve të vlefshmërisë së tyre;
 - ç) personat që ushtrojnë funksione ekzekutive janë përgjegjës për dorëzimin e detyrës, të mjeteve, arkivave dhe të detyrimeve të tjera drejtorit ekzekutiv të Autoritetit.
2. Licencat dhe vendimet e tjera individuale administrative, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, mbeten në fuqi.
3. Punonjësve të DPAC-së që nuk rekrutohen nga AAC-ja për shkak të papërshtatshmërisë me pozicionin e punës, apo nuk pranojnë pozicionin e ri të punës, sipas strukturës së AAC-së, do t'u zgjidhet kontrata e punës në përputhje me Kodin e Punës.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Hartimi i rregulloreve të Autoritetit

1. Ngarkohet këshilli drejtues që, brenda dy muajve nga emërimi i tij, të hartojë dhe të miratojë rregulloren e funksionimit të Autoritetit të Aviacionit Civil.
2. Ngarkohet këshilli drejtues që, brenda tre muajve nga emërimi i tij, të miratojë rregulloret e tjera për funksionimin e përditshëm të institucionit, të propozuara nga drejtori ekzekutiv i Autoritetit.

Neni 28
Shfuqizime

1. Vendimi nr. 96, datë 21.2.1995, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil”, i ndryshuar, si dhe urdhri nr. 25, datë 7.3.2008, i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil”, i ndryshuar, shfuqizohen.

2. Urdhri nr. 4608/1, datë 21.6.2007, i Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil”, shfuqizohet në datën e miratimit, nga këshilli drejtues, të rregullores për funksionimin e Autoritetit.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6441, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 254, datë 11.3.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË QËNDRIMIT TË KOMPANISË SË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN “MINURCAT” TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË
REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore deri më 30 qershor 2010.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë i njëjtë me misionin që kompania ka aktualisht, sigurimi dhe ruajtja e Shtabit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në N’Djamena, kryeqytet i Republikës së Çadit.

Neni 3

Ushtarakët që do të marrin pjesë, në vazhdim, në misionin “MINURCAT” të OKB-së, për ditët e qëndrimit në këtë mision do të marrin, veç pagës mujore, edhe një shpërblim ditor, për vështirësi shërbimi, në masë të barabartë me shpërblimin ditor të ushtarakëve që marrin pjesë aktualisht në këtë mision.

Neni 4

Shpenzimet për pjesëmarrjen e kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë mision janë ato të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për misionin aktual, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura për këtë qëllim.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.6460, datë 12.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 12.3.2010

Doli nga shtypi më 12.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë